



Duke u bazuar në nenin 12, 17, 24 dhe 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”, nenin 28, 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 45 paragrafi 4, nenit 46 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-048, për menaxhimin e financave publike të përgjithshme, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008”, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.02.2019 miratojë këtë;

### V E N D I M

Për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor 2018**.

#### Neni 1

Me këtë vendim miratohet llogaria përfundimtare e Komunës së Suharekës për periudhën **Janar – Dhjetor të vitit 2018**, i cila përmban të dhënat si më poshtë:

Nr.Rd	Mjetet e Komunës	Realizimi 2018	Përqindja
1	Të ardhurat e gjithëmbarshme	16,699,094.05	100.00%
2	Të dalurat e gjithëmbarshme	16,307,057.28	97.65%
<b>3</b>	<b>Teprica e të hyrave ndaj të dalurave</b>	<b>(392,036.77)</b>	<b>-2.35%</b>
a	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave B.R.K	46,227.15	0.28%
b	Teprica e Financimeve nga huamarrjet	18,662.60	0.11%
c	Teprica nga donacionet	46.82	0.00%
d	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetanake 2018	347,356.15	2.08%
e	Tepric e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetanake 2017	168,548.68	1.01%
	<b>Teprica për bartje në vitin 2018</b>	<b>515,904.83</b>	<b>100.00%</b>

#### Neni 2

Të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara si dhe teprica e të ardhurave në raport me shpenzimet e administruara të përcaktuara si në nenin 1 të këtij vendimi, janë shpalosur në bilancin e mjeteve të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor** të vitit 2018 dhe raporti si i tillë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

#### Neni 3

Realizimi dhe zbatimi i këtij vendimi do të bëhet në pajtim me dispozita e Ligjeve në fuqi dhe Rregulloren e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar të komunës së Suharekës.

#### Neni 4

Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset qeveria lokale e Komunës së Suharekës.

#### Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

### KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 400-14939  
 Më datë 28.02.2019

